



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2775 / 4 prot

Datë 21.11.2023

V E N D I M
Nr. 1203/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.11.2023 me:

Objekti: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Medfau*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me nr REF-79237-09-07-2023 me objekt “**Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti**” me fond limit 7,901,168.67 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-10-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.

Ankimues: Operatori ekonomik “Medfau” SHPK Nipt J93610823R
Adresa: LAGJA 5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
Adresa: L.17 Rr. Dalip Peza

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08-09-2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me nr REF-79237-09-07-2023 me objekt “*Blerje reagente pajisje laborator dhe impianti*” me fond limit 7,901,168.67 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-10-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A..

II.2. Në datën 30.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.3. Në datë 06.11.2023 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të fituesit të procedurës objekt ankimi.

II.4. Në datën 09.11.2023 , nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3585 dhe me nr. 2775/2023 prot., datë 09.11.2023 e operatorit “Medfau” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërm, duke kundërshtuar

vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2775 / 2 prot Datë 10.11.2023, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “Medfau” SHPK ngre pretendime.

II.6. Me shkresën nr. 3102/25 prot, datë 14.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2775/3 prot datë 16.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon: “KSHA pas shqyrtimit të ankesës së OE dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE, Arsyeton Gsha verën se :

Nga verifikimi I dokumentave të ngarkuara në SPE ,rezulton se OE ankimues ka ngarkuar në sistemin e prokurimit katalogun. Pas shqyrtimit të katalogut nga KSHA, vërehet se OE ka paraqitur katalog për artikulet 7,13,19,20,31,35. Ankesa e bërë në lidhje me këto pike nga OE ankimues merret në konsideratë. Përsa me siper, Grupi i Shqyrtimit të Ankesës, në mbështetje të pikës 3 të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", VRM-se, nr.285 datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndyshuar. Vendosi 1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik "MEDFAU shpk" për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impiantit".

II.7. Në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 3102/25 prot, datë 14.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 277/3 prot datë 16.11.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin ka pranuar

plotësisht ankesën, si më poshtë vijon: “KSHA pas shqyrtimit të ankesës së OE dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE, Arsyeton Gsha verën se :

Nga verifikimi I dokumentave të ngarkuara në SPE ,rezulton se OE ankimues ka ngarkuar në sistemin e prokurimit katalogun. Pas shqyrtimit të katalogut nga KSHA, vërehet se OE ka paraqitur katalog për artikull 7,13,19,20,31,35. Ankesa e bërë në lidhje me këto pike nga OE ankimues merret në konsideratë. Për më tepër, Grupi i Shqyrtimit të Ankesës, në mbështetje të pikës 3 të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", VRM-se, nr.285 datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Vendosi 1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik "MEDFAU shpk" për procedurën e prokurimit me objekt "Blerje reagentesh laboratorike dhe impjanti".

1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtonte ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.4 Neni 114 pika e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: 1. *Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. *Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalohet 30 ditë.*

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. *Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. *Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

5. *Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë*

Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ të vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor nr. 3102/25 prot datë 14.11.2023 protokolluar me tonën me nr.2775/3 prot datë 16.11.2023 si edhe nga verifikimi i kryer pranë KPP, rezulton se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente sipas pikës 1 të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.4 Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 3102/25 prot datë 14.11.2023 protokolluar me tonën me nr.2775/3 prot datë 16.11.2023 , KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A. e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 gërma “a” të nenit 115 të ligjit nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga *“Medfau” SHPK*. për procedurën e prokurimit *“E hapur, e thjeshtuar”*, me nr REF-79237-09-07-2023 me objekt *“Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”* me fond limit 7,901,168.67 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 24-10-2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A..
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga *“Medfau” SHPK*.
 4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri